

THE CONTRIBUTION OF ALBANIAN PLAYWRIGHTS FROM MACEDONIA TO ALBANIAN DRAMATURGY

Marigonë XHELILI

marigonaxhelili@gmail.com

UDC 821.18-2.09

Conference paper

Abstract

The contribution of albanian playwrights from Macedonia to albanian dramaturgy. The aim of this paper is to notice the symbolism of the myth in literature through drama. Drama is now being created as a reverie, trance or a chaotic metaphysical cirsumstance out of the reality. When we read the drama today , we encounter characters that come from everyday life and characters that come from myths, tales or imagination,that keeps the reader connected with the work until the end, with a unique combination. Drama now becomes more poetic, that is, it becomes more abstract, hit and overthrows myths, the playwrights now see the myth as an opportunity to recount something different. In my survey, I have reviewed the literary activity of some playwrights from Macedonia, as: Xhabir Ahmeti, Resul Shabani, Refet Abazi etc. Without any clear boundary, their texts revolve somewhere between modern and postmodern.

Key words: *Xhabir Ahmeti, Resul Shabani, Refet Abazi, drama. Playwrights, myth, etc.*

Përbledhje

Qëllimi i këtij punimi është që përmes dramës të vërehet simbolika e mitit në letërsi. Drama tanimë krijohet si ëndërrim kllapie, apo si një rrëthanë metafizike e çrregullt, jashtë të vërtetës. Kur lexojmë drama sot hasim personazhe që vijnë nga jeta e përditshmërisë dhe personazhe që vijnë nga mitet, rrëfenjat apo imaginata, por me një ndërthurje unike që e mban lexuesin të lidhur deri në fund me veprën. Drama tanimë bëhet më poetike, domethënë më abstrakte, godet dhe rrëzon mite, dramaturgët mitin tanimë e shohin si mundësi për të rithënë diçka ndryshe. Në studimin tim kam marrë në shqyrtim veprimtarinë letrare të disa dramaturgëve nga Maqedonia, si: Xhabir Ahmeti, Resul Shabani, Refet Abazi etj. Tekstet e tyre rrotullohen diku mes modernes dhe postmodernes, por pa një kufi të qartë.

Fjalët kyçe: *Xhabir Ahmeti, Resul Shabani, Refet Abazi, drama, dramaturgët, miti, etj.*

Hyrje

Drama moderne në Maqedoni në fund të viteve '70 nisi të parapëlqejë tipologjinë e dramës absurde. Ajo bëhet më poetike, domethënë më abstrakte, godet dhe rrëzon mite, dramaturgët mitin tanimë e shohin si mundësi për të rithënë diçka ndryshe. Më pranë saj janë elemente të tilla si paradoksalja, e veçanta dhe e çuditshmja, teatraliteti i gjestit, i veprimit, i mjedisit dhe pakësimi i fjalëve, simbolika e dekoreve dhe e objekteve të rekuizitës, strukturimi i subjektit si ëndërrim (e huazuar nga surrealistët), prania e monologut të brendshëm si strukturë bazike, përzierja e kohëve me vetëdije duke krijuar një “kohë në kohë” apo një “antikohë”, që identifikohet më “kohën psikologjike” pa caqe fizike të matshme, e kthyer nga përbrenda, si shprehje e pështjellimit psikik të personazhit. Pikërisht këto forma e shndërrojnë kohën në kohë të imagjinuar.

Në këtë mënyrë, sado paradoksale të duket, “koha e thyer” nuk e pengon rrjedhën unike të ngjarjes. Cilësi të tilla u shfaqën veçanërisht në dramat e Xhabir Ahmetit, Resul Shabanit, pastaj më vonë kemi shfaqjen e Refet Abazit, Shkëlzen Halimit,¹ Salajdin Salihu²etj.

Brendia

Xhabir Ahmeti ka shkruar dramat: *Oleoria Xhentiterriba* (1979) dhe *Pahintikë* në ëndërr (1978). Aty spikatet një gjuhë moderne në thurjen dramatike, që shkon deri në sprovat e llojit të antidramës. Në dramën *Pahintikë* në ëndërr: “Personazhet e animuara si Kafsha, Druri, ata janë të konvencionalizuar, si i Verbri, Balerina, ata që vijnë nga mitet apo rrëfenjet, si Breshka, Varrtari dhe ata që shfaqen si të njëmendtë si Thaqi, Hoxha, Prifti, gjenden në një konfuzion të

¹ **Shkëlzen Halimi** u lind në vitin 1961. Ka diplomuar në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Shkup. Është i njohur si gazetar, dramaturg, poet. Është marrë edhe me përkthime. Dramat më të njohura janë: *Kufomat e gjalla; Leonard Doka; Zgjidhje; Kësulëbardha; Beteja me dy tela; Na ikën heronjtë e librave; Heronjtë e mëhallës sonë* dhe *Thesi magjie*. Sqarim: Emrat e dramave, janë marrë nga Teatri I Shkupit. Orhan Kadriu, [Dorëshkrim]. Shënimet e inspektorit të skenës. Teatri Shqiptar i Shkupit, Shkup.

² **Salajdin Salihu** (1970) kritik i dramës, dramaturg, poet, pedagog universitar. Ka lindur në Sllatinë të Tetovës, ku e ka kryer shkollën fillore. Shkollën e mesme e ka kryer në Tetovë, studimet universitare në drejtimin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe i ka përfunduar në Universitetin e Tetovës, ka magjistruar në drejtimin e Dramaturjisë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, ndërsa ka doktoruar në Universiteti e Shkupit. Në fushën e arteve dramaturgjike-skenike është shquar me veprimitari kritike të teatrit dhe të dramës. Ka botuar në periodikun dhe të përditshmet një numër të madh vështrimesh kritike dhe studimore për dramën kombëtare dhe botërore, për skenën dhe për shfaqjet e repertorit të Teatrit Shqiptar të Shkupit dhe Teatrit Profesionist të Tetovës. Në vitin 2006 ka botuar dramën *Vonesa*, e cila është vënë në skenën e Teatrit të Tetovës (2007). Në vitin 2012 ka shkruar komedinë *Teatër dashuri dhe marrëzi të tjera*, me të cilën pati shumë sukses.

plotë dhe lëvizin njëherit midis dy realiteteve atij virtual dhe atij real, si në një pelegrinazh drejt hiçit, zhbërjes dhe vdekjes. Ironia dhe sarkazmi shpesh funksionalizohen në dramën e Xh. Ahmetit si mjete të kritikës për të shigjetuar dukuritë e bjerrjes dhe bastardimit shpirtëror e moral të njeriut, posaçërisht të pseudointelektualëve snobë, sikundër, nga ana tjetër, gjendjet e eksituara, ato delirante dhe kllapitë shfrytëzohen për të stigmatizuar tepritë, pasionet shkatërruese, zvetënimin e traditave të shëndosha, energjinë negative që tubohet në individë të veçantë, gjë e cila shndërrohet, herë-herë, në premisë për dhunë, vdirrje, vetëshkatërrim dhe bjerrje kolektive. Në këto hulli ideore lëviz drama Oleoria Xhentiteriba...”³ thotë Josif Papagjoni.

Resul Shabani⁴ ka shkruar dramat: *Anija e vjetër* (1982), *Shi në Uertemont* (1982), *Fani vjen vetëm* (1987), *Monotonia* (1987); *Dashuria e kapitenit* (1999); *Kashta e kumtrit* (1999); *Ujë e krip*. Dramat e tij patën sukses sepse shumica u inskenuan në teatro të ndryshme. Pikërisht disa drama të Resul Shabanit bëjnë paralajmërimin e thyerjes së skemave të realizmit socialist. Në disa nga këto drama në mënyra të shkallëzuara kanë shpërthyer shkëndijat e pluralizmit, të ideve që shprehet një vetëdije e re letrare me premisa të fuqishëm objektivizmi. Dramat e Resul Shabanit që janë ndërtuar në këtë pikëmbështetje, janë:

Shi në Uertomonto, poetika e së cilës tregon një formë absurde të ekzistencës e cila tingëllon si paralajmërim i tronditjeve të vogla përmes situatave groteske-tragjike në të cilat heroi nuk mund ta ndjejë, as ta kuptojë fajin tragjik në të cilin qëndron një logjikë më e lartë e ngjarjeve jetësore. Personazhet si Pikoni dhe sidomos Aleksijviçi kanë sjellje, veprime, synime dhe aspiratat që nxjerrin në sipërfaqe gjendjen e rëndë të raporteve shoqërore që vinë nga konteksti ideologjik, shtërzimet sociale, gjendja e vetëdijes kolektive, frika dhe shtypja.

Anija e vjetër, autori trajton një ngjarje të vitit 1943, ngjarja ndodh në Strugë, njerëzit duan të largohen për shkak të jetës së vështirë. Paraqiten personazh me karakter të dobët që dorëzohen dhe po ashtu me karakter të fortë. Autori me këtë dramë tregon se armiku mbetet i

³ Josif Papgjoni, (2009), *Enciklopedi e teatrit dhe e kinematografisë shqiptare*, Botimet Toena, Tiranë, f. 11-12. Shih më tepër: **Xhabir Ahmeti** (1945) lindi në Përshefc të Tetovës. Shkollën fillore dhe të mesme i ka mbaruar në Tetovë, ndërsa studimet në Universitetin e Shkupit në degën Gjuhë dhe Letërsi Shqipe. Me krijimtari merret që nga vitet '70, ai ka shkruar novelë, tregime, romane por vlerat e mirëfillta i dëshmoi në gjininë e dramës.

⁴ Josif Papgjoni, (2009), *Enciklopedi e teatrit dhe e kinematografisë shqiptare*, Botimet Toena, Tiranë, f. 435. Shih më tepër: **Resul Shabani** (1933) dramaturg, prozator e poet. Ka lindur në Kalishtë të Strugës. Shkollën fillore dhe të mesme i ka kryer në Strugë, kurse të lartën e kreu në Akademinë Pedagogjike në Shkup. Me krijimtari letrare merret që nga vitet e '60-ta të shekullit XX. Shkruan drama, poezi, tregime. Suksesin më të madh e ka arritur në fushën e dramaturjisë.

njëjtë për të gjithë dhe mbetet pushtues edhe po bashkëpunove me atë. Në fund pushkatohen të gjithë pa përjashtim.

Dashuria e kapitenit trajton një problematik shumë delikate të shqiptarëve, largimin e shqiptarëve nga presionet e armikut, Kapiteni paraqet figurën e një intelektuali të vendit, që gjithmonë ka qenë në shënjestër të armikut për t'u njollosur dhe zhdukur në mënyra më poshtëruese. Mirëpo gjithmonë këto mashtrime nuk janë pranuar nga njerëzit, këtu kemi figurën e Teutës që hakmerret dhe nuk e beson assesi atë njollosje të padrejtë që i bëjnë bashkëshortit të saj.

Kashta e kumtrit (*Kashta e kumarit*) po ashtu trajton problematikën e shpërnguljeve të dhunshme të shqiptarëve, këtu kemi personazhin Ylli i cili edhe pse e ka jetën përpara vendos të sakrifikoj veten, duke paraqitur simbolin e qëndresës dhe mosdorëzimit. Kurse në dramat e tjera shihen elemente të antidramës si p.sh në dramat:

Fani vjen vetëm personazhet e kësaj drame janë të përfshirë nga ankthet e ndryshme të jetës së përditshme. Pashku është një personazh që gjendet përpara një mashtrimi të madh, ai është tradhtuar nga bashkëshortja dhe burri i motrës së bashkëshortes, të cilin e ka pritur gjithmonë me nderime dhe si mik shtëpie. Alegorizmi dhe gërshtimi i reales me anën misterioze janë sferat me anë të cilave pasqyrohet tematika e kësaj drame. Pashku në mënyrë absurde arrin të kuptoj të vërtetën e hidhur. Klithma e heshtur që e shqetësonte për një periudhë të gjatë kohore ishte e vërtetë. Në përbajtjen e kësaj drame kemi komunikim dhe gërshtim të jetës së përtejme me të këtejmen, Pashkun e gjithë kjo tradhti arrin ta tjetërsoj, duke e kthyer në një vrasës.

Ujë e krip në këtë dramë kemi personazh të çrregullt, të pasjellshëm, të pavëmendshëm që janë rrëmbyer nga koha dhe nuk e kanë veten në kontroll. Kemi edhe rastin kur Papasi jep kritika negative për poezitë e kitaristit edhe pse nuk i ka lexuar, po ashtu njerëz që trillojnë histori të tëra nga disa fjalë të dëgjuara, dhe në fund kemi grupe njerëzish që edhe pse duan të heqin dorë nga telefoni nuk ja dalin, e lënë vetveten të kontrollohen nga telefonatë. Ato edhe pse janë lodhur shumë nga telefonatë përsëri nuk ja dalin që të mposhtin tundimin për të folur në telefon, të gjitha këto situata absurde paraqesin një realitet tronditës.

Monotonia personazhet e kësaj drame e thyen monotonin e jetës normale, për të ndryshuar! Por jeta e shfrenuar që fillojnë nuk është ndonjë ndryshim i madh, edhe ajo lloj jete duke u përsëritur çdo ditë kthehet në monotoni. Petriti ishte ai që e filloi këtë ndryshim ne jetë duke krijuar një lidhje të gabuar, dhe po ai i dha fund kësaj loje duke vrarë Rambon që ishte në një lidhje të fshehtë me nënë e tij dhe deshi nga qiraxhi të kthehet në pronar shtëpie. Studiuiesi,

Josif Papgjoni në librin *Enciklopedi e teatrit dhe e kinematografisë shqiptare* për dramat e Resul Shabanit thekson se kemi elemente të antidramës.⁵

Refet Abazi⁶ është afirmuar edhe në krijimtarinë inventive me romanin *I kujt është Joni*. Ai po ashtu arriți sukses të madh si dramaturg. Në librin me drama të Refet Abazit “*Jetë me qira*”, ku përfshihen dramat: *Akuariumi; Heshtja; Jetë me qira; Darka e thërrimeve*,⁷ shohim elemente të antidramës, si: thyerje të gjuhës tradicionale, veprime mekanike në kuadër të groteskes duke shkrirë realitetin, misterin, èndrrën dhe synimet që dalin nga shumësia e formave ekzistenciale të jetës shpirtërore e nga ankthet e ndryshme të jetës aktuale, nga situatat pa rrugëdalje, nga pesimizmi.

Dramat e tij kanë tipare ironizuese, demistifikuese apo mistifikuese në synimet për të pasqyruar pakuptimësinë dhe absurdin e jetës moderne. Pasuria e ideve, kërkimi i emocioneve të forta, kllapitë, halucinacionet dhe ankthet, patoset dramatike, situatat shpirtërore, që ngajnjë si të lidhura me të fshehtat e mistershme, frika që vjen nga paranojat etj.

Jetë me qira personazhet e kësaj drame janë të përfshirë nga ankthet e ndryshme të jetës aktuale. Përpjekjet e një regjisori të ri, siç është personazhi Dini, për të arritur të fitojë një punë. Përpjekja e tij për t'u kyçur me sukses në rrjedhat që imponon jeta dinamike e kohëve moderne, kontakti i tij me personazhet e dramës dhe shfaqja e një personazhi siç është i panjohuri, në këtë pjesë kemi gërshtetimin e reales me misteriozen. Nga ana tjetër kemi personazhin Hasan i cili për një kohë të gjatë e ka mbajtur të fshehur dashurin e tij, dhe ka qëndruar duke mos vepruar në heshtje dhe në fund vepron dhe e arrin qëllimin. Hasani shfaqet gjatë gjithë kohës se i ndihmon Dinit por në fund fare gjithçka e ka bërë për të arritur qëllimin vetjak, por duke i ndihmuar në një farë mënyre edhe Dinit.

⁵ Josif Papgjoni, (2009), *Enciklopedi e teatrit dhe e kinematografisë shqiptare*, Botimet Toena, Tiranë, f. 435. Shih më tepër: “*Jo rrallë, në dramat e R. Shabanit krijohen situata të absurdit, në kontrapunktet dhe antinomitë domethënëse midis asaj që métohen si ndershmëri, si normë e detyrueshme kanunore dhe si “zakon i të parëve” dhe asaj që kundërshtohen si bjerrje morale, si vdirrje zakonore apo si degjenerim (pa të drejtë), çka është e kundërtë. Ndërkëq në dramat e Resul Shabanit gjejnë përfaqësim raporte mes lirisë dhe idealeve, të drejtës dhe shkeljes saj, pasioneve dhe detyrimeve morale, të mirës dhe të ligës në rrafsh historike dhe etnike, ku apeli për qytetërim përshtfaqet si kryemotiv dhe tendencë e shprehur qartë.*”

⁶ Josif Papgjoni, (2009), *Enciklopedi e teatrit dhe e kinematografisë shqiptare*, Toena, Tiranë, f. 7. Shih më tepër: **Refet Abazi** (1966) aktor, dramaturg, pedagog. Ka lindur në Tetovë ku e ka mbaruar shkollimin fillor dhe të mesme. Kreu Fakultetin e Arteve Dramatike në Shkup, më 1989, nën drejtimin e regjisorisë të njohur maqedonas Vladimir Milçin dhe fill më pas u emërua aktor në Teatrin e Dramës Shqipe në Shkup, ku pati shumë sukses, duke u bërë shpejtë njëri ndër aktorët më të shquar të këtij teatri.

⁷ Refet Abazi, (2014), *Jetë me qira*, Brezi, Tetovë, f. 306.

Kurse me anë të personazheve të tjerë si: Drejtori, Bastriu, Selma e disa të tjerë autori arrin të paraqesë anët më të errëta të njeriut, siç janë: konflikti ndërmjet ndjenjave, konfliktin tragjik ndërmjet iluzionit dhe realitetit, humbjen e identiteti, e kuptimit jetësor etj.

Akuariumi në këtë dramë pasqyrohet mashtimi apo vetëmashtrimi i personazheve, klithmat e heshtura por domethënëse të Edës, sidomos Edit gjatë gjithë zhvillimit të ngjarjes. Prania e monologut të brendshëm si strukturë bazike, përzierja e kohëve me vetëdije duke krijuar një “kohë në kohë” apo një “antikohë”, që identifikohet më “kohën psikologjike”. Në përfundimin e kësaj drame gërshetohen jeta e këtejme dhe e përtejme por në mënyrë krejtësisht origjinale, ku kemi bisedat ndërmjet Edit që është i gjallë dhe Edës që është e vdekur.

Darka e thërrimeve në këtë dramë kemi gërshetimin e reales me anën misterioze, të errët dhe mitiko-fantastike. Pakuptimsia, humbja e identiteti dhe orientimit jetësor janë ato situata përpara të cilave gjenden personazhet si Linda dhe Leo. Po ashtu kemi përzierje kohësh, personazhet në mënyrë retrospektive kujtojnë të kaluarën e tyre së bashku. Në fund e kuptojmë se personazhet kanë folur dhe vepruar nga pozita e vdekjes, pra të dy janë të vdekur.

Heshtja në këtë dramë kemi dy familje që janë krejtësisht ndryshe nga njëra tjetra. Familja e Arianit paraqet një gjendje kaotike, pjesëtarët e kësaj familje i udhëheqë absurdi dhe jo logjika e shëndoshë, ato fshehin një situatë shumë delikate, jashtë kësaj situate është vetëm Arianë i cili kur e kuption edhe pse shumë vonë, vendos drejtësinë e munguar. Nita është personazhi që mbartë një barrë të rëndë mbi vete, ajo është dhunuar nga i ati kurse e gjithë ngjarja është fshehur nga e ëma, ajo pa mbështetje e ka humbur të gjithë dëshirën për të jetuar. Lypësi është një personazh misterioz që paraqitet në subkoshienten e personazheve, duke i vendosur ato në mendime të thella. Kurse Zana që është e dashura e Arianit dhe babai i saj, paraqesin një familje normale, vetëm kur e kuptojnë të vërtetën arrin të kuptojnë dhe Arianin.

Ajri Begu⁸ ka shkruar dramat: *Dyert* e botuar në vitin 1983 dhe dramën *Gjarpri i shtëpisë* e botuar në vitin 1985. Për dramën *Gjarpri i shtëpisë* regjisori Ahmet Jakupi, në programin e dramës shënon: “*Kjo dramë e shkruar në vargje, në shtresën e kuptimit alegorik, prej fillimit e deri në fund shtrihet si një metaforë në një familje të ngushtë, fillimi i saj është miti, e mbarimin është në rrëthin e ngushtë të familjes. Intriga e dramës është në zbulimin e misionit të gjarprit të shtëpisë, i cili është i pranishëm në tërë pjesën dhe për këtë arsy formë e paraqitjes së gjarprit është reale dhe ireale: gjarpër-njeri dhe njeri-gjarpër. Tema kryesore e dramës është*

⁸ Jakupi, Ahmet (1986, Nëntor, 15). *Gjarpri i shtëpisë*, nga Ajri Begu. [Afishe]. Arkivi i teatrit. Teatri Shqiptar i Shkupit, Shkup. Shih më tepër: **Ajri Begu** u lind në Dibër më 18 mars 1951. Shkollimin fillor dhe të mesëm e kreu në vendlindje, kurse diplomoi në Fakultetin Ekonomik të Zagrebit. Shkroi tregime, poezi dhe drama.

*qëndresa, rezidenca e një familje ndaj gjarpërjinve.*⁹ Më pas vazhdon: “...shtresat alegorike identifikohen nëpërmjet aksionit të pamjeve, ku miti përmes ndarjes në strofa vetvetiu demitezohet.”¹⁰

Bibliografia

- ABAZI, Refet: *Jetë me qira dhe drama të tjera*, “Brezi”, Tetovë, 2014, 305 f.
- AHMETI, Xhabir: *Pahintikë në èndërr*, Shtëpia botuese “Mikena” Manastir, 2008, 102 f.
- SHABANI, Resul: *Shtatë drama*, “Shoqata e shkrimtarëve shqiptarë” Shkup, 1999, 459 f.
- ELSIE, Robert: *Histori e Letërsisë Shqiptare*, përktheu nga anglishtja Abdurrahim Myftiu. Tiranë & Pejë: Dukagjini, 1997.
- ISLAMI, Nebi: *Historia dhe poetika e dramës shqiptare* “ARTC” Prishtinë, 2003.
- ISMAILI, Rifat: *Historia e letërsisë shqipe*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2003.
- IONESCO, Eugene: *Messagio ai naviganti*, 1962, Sipario, Ottobre, 2003.
- JACQUART, Emmanuel: *Le theatre de derision*, Paris, 1974.
- KRAL, Vladimir: *Hyrje në dramaturgji*, përktheu nga kroatistja Prof. Dr. Nebi Islami.
- NDOCI, Naxhi: *Shikime nga skena*, “Flaka e vëllazërimit” Shkup, 1991.
- PAPAGJONI, Josif: *Enciklopedia, teatri dhe kinematografja shqiptare*, Toena, Tiranë, 2009.
- QOSJA, Rexhep: *Historia e letërsisë shqipe (Romantizmi I)*, Rilindja, Prishtinë, 1990.
- VINCA, Agim: *Teoritë letrare*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2012.

⁹ Jakupi, Ahmet (1986, Nëntor, 15). *Gjarpri i shtëpisë*, nga Ajri Begu. [Afishe]. Arkivi i teatrit. Teatri Shqiptar i Shkupit, Shkup. Shih më tepër: Besohej se çdo shtëpi ka një gjarpër të vetin, që quhet me emra të ndryshëm: vitorie, bolla e shtëpisë, ora e shtëpisë, toksi etj. Në mitologjinë shqiptare ora e shtëpisë përfytyrohet herë si grua, herë si gjarpër. Ajo ndihmon dhe u sjell fat të mirëve, ruan njerëzit, shtëpinë, fisin. Në gojëdhënët shqiptare fuqia jetëdhënëse e gjarprit qëndron në lëkurën e tij. Ai duke hedhur lëkurën, duket sikur ripërtërihet, ndaj është shndërruar në simbol të pavdekësisë, të aftësisë krijuese. Këtë tregon edhe motivi i metaforës: ditën gjarpër dhe natën nj djalë i bukur, që hasim në legjendat tona.

¹⁰ Jakupi, Ahmet (1986, Nëntor, 15). *Gjarpri i shtëpisë*, nga Ajri Begu. [Afishe]. Arkivi i teatrit. Teatri Shqiptar i Shkupit, Shkup.